



### Kur duhet te kryeni Pap Test-in:

- Nese kryeni jete aktive seksuale
- Nese jeni mbi 30 vjeç.
- Nese e keni kryer Pap test-in e fundit, me teper se 10 vjet me par e.
- Edhe nese Pap test-i i fundit, ka rezultuar ne njefare menyre jonormal.
- Nese mjeku apo infermierja jua r ekomandon kryerjen e Pap test-it.
- Nese keni hemoragji te shtuar.

**KESHILLOHET QE GRUAJA MBASI KALON  
MOSHEN 30 VJEÇ, TE KRYEJE PAP TEST-IN  
RREGULLISHT DHE NJE HERE NE ÇDO 10 VJET**



### Ku mund te kryhet një Pap test?

Pap test-i mund te kryhet nga nje mjek apo nje tjeter personel i shendetesise i cili punon ne nje spital ose klinike private, ose institucion mjeksor.

Shumica e Pap test-eve rezultojne normale.

### NDJEKJA E VAZHDUESHME ESHTË E RENDESHISHME

- Mjeku do t'ju kontaktoje nese Pap test-i qe keni kryer, nuk rezulton normal.
- Jo te gjitha qelizat anormale duhen konsideruar si kanceroze.
- Infermierja do t'ju tregoste se kur do ta merrni perqigjen e ekzaminimeve te kryera.
- Mjeku dhe infermierja do t'ju orientojne nese do te keni nevoje per trajtim apo mjekim te metejshem.

### Ndjekja e vazhdueshme eshte e rendeshishme ne rast te:

- Ndonje rezultati jo normal.
- Per diagnozen e hershme.
- Per trajtimin e hershem.
- Per parandalimin e perhapjes se kancerit ne pjesë te tjera te trupit.



INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK



**ZBULIMI I HERSHEM, PERMIRESON SHANSET  
PER NJE TRAJTIM TE SUKSESSHËM.**

**MOS PRIT QE TE SHFAQEN SIMPTOMAT, POR  
KRYEJ PAP TEST-in NE MENYRE PERIODIKE !**




## Çfare eshte kanceri i qafes se uterusit?

- Qafa e uterusit (mitres) eshte pjesa me e poshtme e uterusit (mitres).
- Kanceri i qafes se uterusit (i njohur gjithashtu edhe si kanceri i cerviksit) njihet si njera nga format me te shpeshta te kancerit, midis grave. Ai hyn ne grupin e semundjeve, te cilat mund te kurohen dhe mjekohen, nese trajtohet qysh ne stadet e hershme.

## Faktoret e riskut qe shkaktojne kancerin e qafes se uterusit

- Ne rast se Pap test-i nuk kryhet ne menyre te rregullt.
- Ne rast se aktiviteti seksual fillon para moshes 15 vjeç.
- Nese vuani nga nje infeksion qe transmetohet seksualisht.
- Nese pini duhan.
- Ne rast se perdorni nje diete jo te shendetshme dhe te varfer ne fruta dhe perime



## Çfare mund te behet per te parandaluar kancerin e qafes se uterusit?

- Kryeni Pap test-in, ne menyre te rregullt.
- Mbani vetem nje partner seksual.

## Çfare eshte pap test-i?

- Pap test-i, esh e nje ekzaminim qe kryhet nga mjeku apo infermierja ne menyre te thjeshte, te shpejte, te padhimbsime dhe qe nuk sjell asnjë dem.
- Ky ekzaminim kontrollon nese gjenden qeliza jonormale ne pjesen hyrese te qafes se uterusit.
- Keto qeliza jonormale mund te mos jene kanceroze, por nese ato lihen te patrajuara, mundet qe te shkaktojne edhe kancer.



## Si kryhet marrja e nje pap test-i?

- Pasi gruaja shtrihet ne tavolinan ekzaminuese, mjeku apo infermierja vezhgojne nese ne zonen vaginale, ka shenja infektione apo te ndonje problem tjeter.
- Mjeku apo infermierja do te vendosin nje speculum per te hapur vaginen.
- Gjate kryerjes se ekzaminimit, mjeku apo infermierja do te perdorin nje furçe te vogel apo nje spatul per te marre disa qeliza prej qafes se uterusit apo te zones perreth saj.
- Eshte mire qe nese keni ndonje pyetje per mjekun apo infermieren perkatese, t'ju drejtoheni atyre para se ata te jene larguar.
- “Mostra” e marre, vendoset mbi lame xhami dhe dergohet ne laborator, ku do t'i nenshtrohet ekzaminimeve te metejshme per pranine e qelizave anormale apo kanceroze.
- Nese gjenden qeliza anormale, gruaja njoftohet per t'u rikonsultuar me mjekun per trajtimin e metejshem qe do t'i duhet te marre.
- Trajtimi i semundjes qysh ne stade te hereshme, do te parandalonte kancerin e qafes se cerviksit.